



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT

PROJEKT
PËR NDËRTIM LERE PLASMASI NË KULLOTË

MIRATOHET
ZV/ KRYETARI

Asim SULA



Fshati : Shushicë
Nj. Administrative : Shushicë
Zona kadastrale : 1672
Emri popullor i vendit : Ligatë e Poshtëme
Ekonomia Pyjore : Polis-Vasjan
Ngastra/Nënngastra : 100/b

PROJEKTOI
Ing. Hasan IDRIZI

DREJTORI
Eraldo HAZIZOLLI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Shpëtim ÇULLHAJ

KONTROLLOI
Ing. Astrit MUÇA

VITI - 2025

KAPITULLI I KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

• Përmbledhja e projektit:

Hartimi i projektit me objekt “Ndërtim Lere Uji” në n/ngastrën pyjore nr.100/b të ekonomisë pyjore “Polis-Vasjan”. Vendi ku propozohet ndërtimi i leres ndodhet në territorin e fshatit Shushicë, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan.

• Qëllimi:

Punimet e propozuara janë bazuar në rekomandimet e planit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Polis-Vasjan të hartuar në vitin 2024, si dhe planifikimin e projekt-buxhetit të bashkisë Elbasan për vitin 2025 të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024. Ndërtimi i leres së ujit në ngastrën nr.100/b, në fshatin Shushicë, Njësia Administrative Shushicë ka si qëllim sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë e imët dhe të trashë në periudhën e nxehtë të verës, ku reshjet mungojnë dhe nuk sigurohet uji i pishëm për blegtorinë. Ndërtimi i kësaj lere në kushtet aktuale përbën një domosdoshmëri tjetër pasi do të shërbejë si një burim i domosdoshëm dhe i rëndësishëm uji në rast të shfaqjes së ndonjë zjarri në periudhën e nxehtë të vitit për t’u përdorur nga strukturat e shuarjes së zjarrit, për fondin pyjor që rrethon këtë kullotë. Me ndërtimin e kësaj lere dhe pasi të vetmbushet me ujë në periudhën e vjeshtës dhe të dimrit, me reshje të bollshme, do të shërbejë si një pikë e domosdoshme për plotësimin e nevojave me ujë të blegtorisë të fshatrave Shushicë, Fushë-Bualt, Polis i Vogel, Polis-Vallë, etj., në periudhën e nxehtë të vitit kur ka mungesë reshjesh. Ndërtimi i kësaj lere në këtë ngastrë, përbën një nga masat për një përdorim të qëndrueshëm të kullotave. Duke konsideruar mjaft të rëndësishëm rolin dhe funksionin e kësaj lere, pasi të ndërtohet, pasi bazuar në rekomandimet e Planit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të Ekonomisë Pyjore “Polis-Vasjan” si dhe në kërkesët e vazhdueshme dhe propozimin e blegtorëve të këtyre fshatrave, do të bëjë të mundur sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë në këtë territor në periudhën e nxehtë të vitit.

• Objektivat e Projektit:

Nëpërmjet ndërhyrjes me punime “Për ndërtim lere uji” synohen të arrihen këto objektiva:

- Plotësimi i nevojave për ujë të pishëm të blegtorisë që kullosin në këtë zonë.
- Përmirësimi i shfrytëzueshmërisë së fondit kullosor.
- Shtimi i numrit të bagëtive nga ana e fermerëve.
- Zgjatjen e periudhës së kullotjes (*mish, qumësht etj.*) si rezultat i shfrytëzimit me të mirë të kullotës dhe sigurimit të ujit të pijshëm.
- Shtimi i produkteve blegtorale.
- Ulja e nivelit të papunësisë dhe përmirësimin e nivelit ekonomik të banorëve të zonës.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e fondit pyjor/kullosor.
- Konsum më i pakët i energjive të kafshëve në kullotë për arsyet të shkurtimit të distancave të lëvizjes për sigurimin e ujit.
- Sigurimi i ujit të pishëm për kafshët e egra.
- Përdorimi i kësaj rezerve ujore në rastet emergjente të shfaqjes së zjarreve në pyje.

Me ndërtimin e lerës në ngastrën nr.100/b, në Ekonominë Pyjore "Polis-Vasjan" dhe vetmbushjen me ujë gjatë periudhës së rënies së reshjeve do të bëjë të mundur krijimin e kushteve me të mira për sigurimin e ujit të pijshëm në periudhën e thatë pa reshje në këtë ngastër por dhe në ngastrat të tjera në afërsi të saj. Ndërtimi i kësaj lere do të përmiresoj ndjeshëm kushtet e furnizimit me ujë të blegtorisë vendase por dhe të tufave që shtegtojnë dhe lëvizin në këtë teritor në periudhën e verës nga fshatrat kufitarë me fshatin Shushicën, sigurimin e ujit për kafshët e egra që jetojnë në këto territore i cili në fakt është një habitat mjaft i gjerë dhe i populluar nga një numër i konsiderueshëm kafshësh të egra.

Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumfunksional i këtyre kullotave duke synuar rritjen e kapaciteteve të shfrytëzimit dhe përdorimit të kullotës do të shpjerë me pas në rritjen e prodhimtarisë së produkteve blegtorale, numrit të mbarështimit të krerëve etj.

• Plani i punës:

Partneret kryesore për zbatimin e projektit janë komuniteti i fshatit Shushicë, Njësia Administrative Shushicë dhe struktura e administrimit të pyjeve pranë bashkisë Elbasan, Ritmiki i pyjeve kryerjes së punimeve nga ana e stafit drejtues të Subjektit Fitues e drejtuesi teknik i punimeve, do të organizohen kontrole për cilësinë e kryerjes së punimeve, në rast konstatimi të metash, lihen detyra për përmirësim. Punimet për ndërtimin e lerës, fillojnë mbas lidhjes së kontratës e trajnimit të punëtorëve.

PP1	Manaxhimi i Projektit	Afati
Objektivi	Sigurimi i nevojave për ujë të pijshëm për blegtorinë.	
Lideri PP	Nj. Adm. Shushicë, Bashkia Elbasan, Shërbimi Pyjor bashkisë Elbasan.	
Detyrat	D.1.1. Sigurimi i fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve nga banorët e zonës përreth objektit do bëhet nga stafi drejtues i subjektit fitues.	1 muaj nga lidhja e kontratës.
	D.1.2. Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve do bëhet nga stafi drejtues i subjektit fitues dhe drejtuesi teknik i zbatimit të punimeve.	Para fillimit të punimeve
	D.1.3. Piketimi sipas specifikimeve të projektit do bëhet nga punëtorët, stafi drejtues dhe drejtuesi teknik i zbatimit të punimeve.	1-2 ditë para fillimit të punimeve
	D.1.4. Punimet e gërmimit për hapjen e gropës sipas përmasave të përcaktuara në projekt, punëtorësia, monitorimi nga drejtuesi teknik i punimeve, stafi i shoqatës.	3 muaj
	D.1.5. Sigurimi dhe transporti i bazës materiale të nevojshme, stafi i subjektit.	1 muaj
	D.1.6. Shtrimi dhe lidhja e shtresave të plasmës, dheut, kalldremit, punëtorësia, monitorimi nga drejtuesi teknik i punimeve, stafi i subjektit.	2 muaj
	D.1.7. Ndërtimi i Lerës së ujit, punëtorësia, monitorimi nga drejtuesi teknik, stafi i subjektit.	Rreth 7 muaj (Realizimi i plote).
	D.1.8. Kontrolli i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës nga drejtuesi teknik i punimeve dhe Shërbimi Pyjor, Bashkia Elbasan.	Gjatë vitit 2025 ose 2026.
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i regjimit të furnizimit me ujë të pijshëm për blegtorinë, rritja e rendimentit të prodhimeve blegtorale, shtimi i numrit të krerëve me bagëti që mbarështojnë fermerët e zonës, përmirësimi i kushteve ekonomike të komunitetit, ndërgjegjësimi i komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullor.	

KAPITULLI II

STUDIMI I OBJEKTIT

- **Vendosja gjeografike dhe administrative:**

Objekti: "Ligata e Poshtëme" bën pjesë në ekonominë pyjore Polis-Vasjan, zonën kadastrale 1672 nën/parcela 100b, në Nj. Adm. Shushicë, Bashkia Elbasan, lartësia mbi nivelin e detit është 1015 m.

- **Kufijtë Natyral:**

Objekti: "Ligata e Poshtëme" ku planifikohet të ndërtohet lera ka këta kufij natyral:

Në veri : Ngastra nr.13/b

Në jug : Ngastra nr. 100/a

Në lindje: Ngastra nr. 100/a

Në perëndim : Ngastra nr.13/b, 100a

- **Sipërfaqja:**

Parcelat/nënparcelat nr.37c, 88b, 94b, 95b, 97b, 99b, 100b dhe 108b, EP.Polis-Vasjan ka një sipërfaqe prej 584.56 ha, e cila shfrytëzohet për kullotje gjatë periudhës Maj - Tetor nga barinjtë e fshatrave Shushicë, Fushë-Buall, Polis i Vogël dhe Polis-Valë.

- **Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:**

Ngastra nr.100/b, përshkohet nga një rrugë autopyjore që lidh fshatin Shushicë me ngastrat pyjore të ekonomisë pyjore "Polis-Vasjan" dhe "Shpat-2" në periferi të saj, por kjo rrugë lidh gjithashtu fshatin Fush-Bullë të Njësise Administrative Shushicë me Bashkinë Elbasan. Vendi ku do të ndërtohet lera ndodhet rreth 10 km nga fshati Shushicë dhe qendra e Njësise Administrative Shushicë.

- **Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia:**

Vendi ku është përcaktuar të ndërtohet lera në ngastrën nr.100/b , është një sipërfaqe jo shumë e pjerrët, sipërfaqe e rrafshët kullosore (*pak a shume gropë*) e cila krijon mundësinë e grumbullimit të reshjeve në periudhat e pasura me reshje për mbushjen e lerës. Formacionet toksore të kësaj ngastre janë toka livadhore-malore të vendosura mbi formacione supargjilore të shkëmbit amnor.

- **Kundrejtimi:**

Kundrejtimi i përgjithshëm i ngastrës është Perëndimor, ndërsa kundrejtimi i sipërfaqes ku do të ndërtohet lera është i rrafshët.

- **Lartësia:**

Ngastra pyjore nr.100/b, ka një lartësi mbi nivelin e detit 1074 m. Vendi i përzgjedhur për ndërtimin e lerës në këtë ngastër ka një lartësi mbi nivelin e detit 1015 m.

- **Rrjeti hidrografik:**

Në kushtet aktuale kjo ngastër nuk përshkohet nga ndonjë prroskë, sidomos në pjesën e sipërme të saj. Ndërsa në pjesën e poshtme dhe vazhdimi i ngastres 100/b në drejtim të fshatit Shushicë është një prroskë që zakonisht në periudhën e pasur me reshje ka rezerva ujore, sidomos pjesa e poshtme e kësaj prroske, ndërsa në periudhën pa reshje, sidomos atë të verës dhe fillim vjeshtës nuk ka rezerva ujore për blegtorinë. Kjo është dhe arsyeja që planifikuam ndërtimin e kësaj lere.

- **Përbërja e bimësisë:**

Përdorimi i territorit në këtë ngastër është kullotë. Përbërja e bimësisë ekzistuese barishtore përfaqësohet nga Graminace (*Festuke sp, Tërfile. etj.,*) të cilat kanë një zhvillim të mirë në pjesë të ndryshme të kësaj ngastre, kjo në varësi të thellësisë së formacioneve toksore.

- **Kushtet klimatike:**

Bimësia dhe sidomos bimësia barishtore ka një lidhje të ngushtë dhe të ndërsjelltë me faktorët klimatik të zonës. Mbështetur në ndarjen të vendit tonë si dhe pozicionin gjeografik të kësaj ngastre, klima është mesdhetare kontinentale malore juglindore. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat lidhur me reshjet dhe temperaturat mesatare mujore e vjetore, marrë nga stacioni meteorologjik Elbasan.

TË DHËNAT KLIMATIKE (Mesatarja 10 vjeçare, stacioni metrologjik Elbasan)

Nr.	EMËRTIMI	MUAJT												Mesatarja Vjetore
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik.	Gusht	Shtator	Tetor	Nëndor	Dhjetor	
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	Reshjet mesatare	118	123	97	97	119	62	41	47	72	90	139	122	1127
2	Temperaturat mesatare	6	7.3	9.5	13.1	17.4	21.2	23.5	23.9	20.4	15.8	11	7.6	14.7

- **Tokat:**

Toka ka një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe shtrirjen e bimësisë drusore, por dhe asaj barishtore. Në tërësi ashtu si bimësia, mikroklima dhe tipet e tokës paraqiten të larmishme, duke ndjekur ligjësitë e vertikalitetit. Kjo ngastër kryesisht përbëhet nga toka livadhore malore të hijta kafe të murrme pyjore, të vendosura mbi formacione gëlqerore, me një profil të diferencuar, ngjyra e horizonteve të sipërme është mesatare, ndërsa ato të horizonteve me në thellësi paraqiten me një ngjyrë të hirtë të theksuar. Nga mbikqyrja që i kemi bërë formacionit tokësor në vendin e parashikuar për ndërtimin e lerës, ka rezultuar se hapja e trupit të lerës në thellësinë 2.4

m nuk do të paraqese vështirësi gjatë procesit të gërmimit, në shfaqjen e gurëve të mëdhenj apo formacione shkëmbore të fortë dhe unik.

- **Nevojat për ujë të pijshëm për blegtorinë:**

Në kushtet aktuale, kullotja e blegtorisë në këtë ngastër kullosore, por dhe në ngastra të tjera rreth kësaj ngastre, që kullosin dhe në brendësi të pyjeve të ekonomive pyjore “Shpat-2” dhe “Polis-Vasjan”, nga blegtorët e fshatrave Shushicë, Fushë-Buall, Polis i Vogël, Polis-Valë, bëhet kryesisht gjatë periudhës së verës dhe të vjeshtës. Por problem paraqitet sitautat e sigurimit të ujit të pijshëm për blegtorinë në stinën e nxehtë të verës dhe fillimit të vjeshtës. Me poshtë po paraqesim në formë tabelare nevojat për ujë të pijshëm për blegtorinë, që kullosin në këtë teritor dhe kërkojnë ujë të pijshëm.

Nr.	Emërtimi	Nj. Matjes	Numri bagëtiqe që kullosin	Nevoja	Periudha kullotjes	Nevojat/sezon	
				ditore l/ditë		l.	m ³
1	Njëthundrak	Krerë	10	60	120	72,000	72
2	Gjedh	Krerë	30	50	120	180,000	180
3	Të leshta (Dele)	Krerë	180	5	120	108,000	108
4	Të dhirta (Dhi)	Krerë	44	6	120	31,680	32
Shuma:						391,680	392

Sic shikohet dhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, nevojat për ujë të pijshëm, për numrin e krerëve që përdorin këtë kullotë janë 392 m³ ujë në sezon.

Aktualisht barijtë përdorin për sigurimin e ujit të pishëm për blegtorinë një lerë që ndodhet në afërsi të fshatit, i cili mund të sigurojë rreth 170 m³ ujë në sezon. Për sigurimin e nevojave aktuale nevojiten dhe 169 m³ ujë të pishëm për blegtorinë.

Sigurimi i ujit të pishëm do ndikojë në shtimin e numrit të bagëtiqe që mund të kullosin në këto zona nga ana e fermerëve të fshatrave Shushicë, Fushë-Buall, Polis i Vogël dhe Polis Valë, të cilët aktivitetin kryesor ekonomik e kanë të përqëndruar tek mbarështrimi i blegtorisë.

KAPITULLI III

TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

- **Zgjedhja e vend ndërtimit të lerës:**

Zgjedhja e vendit të duhur, ku do të ndërtohet lera me plasmas është shumë e rëndësishme e cila diktohet nga vetë natyra konstruktive e kësaj vepre, por dhe në funksion të përdorimit sa më të mirë nga blegtorja. Pra e rëndësishme është: Mundësia e ndërtimit në parametrat teknik të projektuar ; Mundësia e grumbullimit të ujit sa më të pastër për mbushjen e lerës në periudhën e pasur me reshje dhe shfrytëzimi sa më efektiv dhe në funksion të kullotjes për blegtorinë. Nisur nga këto kritere më themelore, vendi i përcaktur për ndërtimin e lerës me plasmas në ngastrën nr.100/b është mëse i përshtatshëm pasi sipërfaqja është pak a shumë e rrafshët, fundshpati e mbuluar me bimësi barishtore. Në këtë vend, ndërtimi i lerës me parametrat teknik të projektuar është plotësisht i mundshëm, sipërfaqja e bazenit për grumbullimin e ujërave garanton

mbushjen e lerës në periudhën e pasur me reshje dhe përdorimi nga blegtoria në funksion të kullotjes ka një produktivitet maksimal.

Në funksion të reshjeve mesatare vjetore dhe sipërfaqes së bazenit që grumbullon ujë në lerë, është e mundur sigurimi i ujit për mbushjen e saj.

$$Vu = R \times S \times K / 1000 \quad Vu = 1127 \times 700 \times 0.4 / 1000 = 315,56 \text{ m}^3$$

ku: Vu : Volumi i ujit në m^3 .

R : Reshjet mes. Vjetore në mm .

S : Sip. e bazenit që sjell ujë në lerë në m^2 .

K : = 0.4 (Koefficienti i rrjedhjes së ujit në sip.)

• **Pikëtimi:**

Procesi i pikëtimit të lerës ka një rëndësi të veçantë i cili ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ecurinë e zbatimit të proceseve të tjera, për ndërtimin e lerës dhe në fund të fundit në arritjen e objektivit përfundimtar, përfundimin e ndërtimit në kushte optimale të veprës. Pikëtimi i lerës do të bëhet domosdoshmërisht nga derjtuesi teknik i punimeve, mbështetur dhe nga punonjës me pervojë në pikëtimin dhe ndërtimin e këtyre veprave. Forma e lerës do të jetë rrethore. Fillimisht pasi janë siguruar mjetet e nevojshme për piketim (*fije deri 25 ml, metër shirit, piketa, bojë vaji etj.*) duhet të kihet kujdes fiksimi i qendrës së lerës. Përcaktimi i vendit të qendrës (*nga ku bëhen matjet e tjera të përmasimit të elementëve të lerës*) duhet të zgjidhet në funksion të përmbushjes së elementëve të planifikuar për ndërtim. Nga qendra e lerës me rreze 3.4 m, bëhet pikëtimi i diametrit të vogël të lerës ($6 \text{ m} + 0.8 \text{ m}$ *gërmim*) duke përfshirë shtresën mbi plasmas (20 cm) dhe shtresën e kalldrëmit (20 cm) në të dyja anët e diametrit. Perimetri i diametrit të vogël fiksohet me piketa të ngulura në tokë dhe me bojë i cili krijon formën e plotë të perimetrit të vogël. Më pas bëhet pikëtimi i diametrit të madh të lerës me rreze 8.9 m i cili përfshin dhe shtresat mbushjes mbi plasmas (20 cm) dhe shtresën e kalldrëmit (20 cm). Fiksimi i perimetrit të pikëtuar bëhet njëloj siç vepruam për pikëtimin e diametrit të vogël të lerës. Më pas bëhet pikëtimi i diametrit të trotuarit me rreze 9.4 m (*rreth 1 m gjerësi mbi diametrin e madh të lerës*). Fiksimi i piketave për krijimin e këtij perimetri bëhet njësoj siç u veprua në rastin e pikëtimit si mësipër. Pikëtimi i diametrit të oborrit nuk do të bëhet në fillim pasi kjo do të shikohet pas ndërtimit të elementëve të mësipërm të lerës dhe në funksion të mundësisë së vendit ku do të ndërtohet lera. Mbi këtë bazë janë bërë dhe llogaritjet e volumit të gërmimit dhe të kapacitetit ujëmbajtës, prandaj gjatë pikëtimit perimetrat e mësipërm duhet të ruhen me përpikmëri. Forma e lerës do të jetë rrethore.

• **Gërmimet për hapjen e gropës:**

Gërmimi duhet të fillojë, pasi të këtë përfunduar pikëtimi i elementëve për ndërtimin e lerës. Gërmimi fillon nga diametri i vogël i lerës në drejtim të diametrit të madh. Gërmimi bëhet i shkallëzuar dhe duhet të kihet kujdes që të ruhet pjerrësia e projektuar e skarpatës (12 %). Pasi krijohet një seksion profili deri në tabanin e lerës në thellësinë 2.4 m, duke formuar skarpatën e projektuar, vazhdohet më pas gërmimi deri në përfundim të gërmimeve dhe formimin e trupit të lerës. Gjatë gërmimit dherat duhet të largohen në togje në periferi të lerës rreth 10-15 m largësi dhe duhen të sistemohen duke i niveluar me sipërfaqen e tokës në afërsi. Gjithashtu duhet patur kujdes që dherat e pastër nga elementët e huaj (*gurë, rrënjë etj.*) të veçohen nga pjesa tjetër e dherave në mënyrë që ky volum dheu pasi të sitet do të përdoret më pas për shtrimin mbi plasmas. Në përfundim të gërmimeve rikontrollohen dhe njëherë përmasat e projektuar të lerës

dhe kur konstatohen mospërputhje, bëhet korigjimi i tyre. Më pas bëhet rrafshimi i sipërfaqes së skarpatës dhe sipërfaqes së bazës së vogël të lerës, duke e pastruar nga ç'do element i huaj (*gurë, rrënjëza etj.*). Duhet patur kujdes që ky proces është shumë i rëndësishëm sepse mbi këtë shtresë do të vendoset plasmasi dhe sipërfaqja duhet të jetë shumë e pastër në mënyrë që të mos çahet plasmasi nga prania e ndonjë elementi të huaj në këtë sipërfaqe, gjatë shtrimit të plasmasit, por dhe gjatë mbushjes me dhe. Në ato pjesë të sipërfaqes që ka ashpërsi të strukturave të tokës rekomandohet hedhja mbi këtë sipërfaqe të një shtresë të hollë dheu të situr me prani të lagështisë së lehtë nga spërkatja e tij.

• Shtrimi i fletëve të plasmasit:

Pasi është siguruar sasia dhe cilësia e plasmasit në parametrat e përcaktuar më parë, fillimisht bëhet një rikontroll i sipërfaqes së pastruar të lerës të gatëshme për shtrimin e plasmasit. Kur konstatohen të meta, bëhet pastrimi dhe korigjimi i sipërfaqes së konstatuar me të meta. Paraprakisht punëtorët që do të marrin pjesë në këtë operacion të rëndësishëm dhe delikat duhet të jenë zbathur (*pa këpucë*) sepse rrezikohet çarja e plasmasit nga shkelja mbi të. Gjithashtu në këtë proces duhet të marrin pjesë punëtorë me eksperiencë në të tilla punime, por gjithësesi paraprakisht punëtorëve ju këshillohen dhe demonstron nga drejtuesi teknik praktika e punës që do të ndiqet. Fillimisht shtrihet shtresa e parë e plasmasit, në gjerësinë që ka fleta e plasmasit duke filluar nga qendra e sipërfaqes së lerës deri në sipërfaqen e trotuarit. Në dy anët e kësaj shtrese plasmasi shtrihet fleta tjetër e plasmasit. Punëtorët pjesëmarrës duke filluar nga qendra e lerës, afër njëri tjetrit bëjnë bashkimin e buzeve të dyja fletëve duke krijuar tegelet bashkuese, palosja bëhet nga jashtë brenda (*në sencin orar*) buzët e fletëve të plasmasit mbivendosen në një hapesirë 40 cm. Tegelet e palosjes duhet të kenë një gjerësi rreth 8 cm dhe ku të krijohen jo më pak se 5 palosje. Në përfundim të palosjes së fundit, nga punëtorë të tjerë, vendosen gurë të lëmuar mbi tegela në mënyrë që të mos hapen tegelat e palosur, duke qëndruar të tendosur dhe gjithashtu ngjiten me ngjitëse vertikalsiht në shumë vende të gjatësisë së palosjes. Kjo procedurë vazhdohet deri në plotësimin e të gjithë sipërfaqes së lerës me plasmë. Ndërsa shtresa e dytë e plasmasit vendoset përpjendikular me shtrirjen e fletëve të shtresës së parë. Procedura e punës dhe krijimit të tegelave është e njëlllojtë me atë të treguar për shtrimin e shtresës së parë të plasmasit, por para se të shtrihet shtresa e dytë e plasmasit duhet largohen gurët e lëmuar që janë vendosur për mbajtjen tendosur të tegelave të shtresës së parë.

• Aplikimi i shtresës së dheut mbi plastmas:

Pas përfundimit të shtrimit të shtresave të plasmasit, menjëherë duhet të filloj puna për hedhjen e shtresës së dheut mbi plasmë. Kujtojmë se dheu që do të përdoret për shtrim mbi plasmë duhet të jetë i pastër nga elementë të huaj sepse dëmton (çan) plasmin kur të hidhet mbi të dhe të ngjeshet me tokmak. Hedhja e shtresës së dheut mbi plasmë (20 cm) duhet të bëhet nga sipërfaqja e bazës së lerës dhe me pas drejt periferisë. Dheu duhet të ketë pak lagështi në mënyrë që gjatë ngjeshjes të mund të krijojnë lidhjen e shtresave të dheut të hedhura. Për këtë kur mungon kjo lagështi rekomandohet spërkatja pak me ujë gjatë hedhjes së dheut. Hedhja e dheut bëhet me tezgë (*dy punëtorë*) të cilët duhet të jenë zbathur në mënyrë që të mos dëmtojnë shtresat e plasmasit. Me hedhjen e dheut mbi plasmë dhe ngjeshjen e tij me tokmak, paraprakisht hiqen dhe gurët e lëmuar të vendosur mbi tegela dhe nxirren jashtë me tezgë. Gjatë punës për hedhjen e dheut mbi plasmë të mund të shkelet sa më shumë mbi sipërfaqet e shtruar me dhe, dhe të shmanget sa të jetë e mundur kalimi mbi plasmë. Në periferinë e trotuarit të lerës bëhet një kanal me seksion 20 x 20 cm, në të cilën futen mbarimet e fletëve të plasmasit të cilat fiksohen

me gurë të ndryshëm përgjatë gjithë gjatësisë së këtij perimetri. Në përfundim bëhet një kontroll i përgjithëshëm në të cilën bëhet ndonjë korigjim nëse konstatohet ndonjë shmangie apo parregullsi. Dheu që do të përdoret për shtresën mbi plastmas duhet të jetë i situar në shosha me vrima që kanë përmasa 2 x 2 cm, duke e pastruar nga guralecët e pranishëm apo mbeturina të tjera.

- **Shtresa e kalldrëmit:**

Me përfundimin e procesit të punës, atë të shtrimit të shtresës së dheut mbi plasmas duhet të procedohet me shtrimin e shtresës së kalldrëmit me gurë. Paraprakisht duhet të jenë siguruar volumi i gurëve të planifikuar për ndërtimin e kalldrëmit, të cilët vendosen në periferi të lerës. Puna për bërjen e kalldrëmit me lartësi 20 cm. fillon nga qendra e lerës dhe vazhdohet më pas duke vazhduar në të gjithë sipërfaqen e lerës deri dhe sipërfaqen e trotuarit. Kalldrëmi duhet të jetë kompakt, ku gurët nuk duhet të lëvizin kur ushtrohet peshë mbi ta dhe për këtë në hapsirat midis gurëve, karikohen me gurë më të vegjël për të rritur qëndrueshmërinë e kalldrëmit. Kalldrëmi duhet të përfundojë deri në perimetrin e trotuarit të lerës. Gurët që do të përdoren për shtrimin e kalldrëmit duhet të jenë unik, jo të plasaritur dhe të dëmtuar nga faktorët atmosferik me madhësi 20 cm. Ndërtimi i kalldrëmit i cili fillon nga qendra, bëhet duke i vendosur gurët në këmbë, ngjitur me njëri tjetrin me një kënd të vogël në mënyrë që të shkelin njëri tjetrin. Gurët që do të përdoren për kalldrëm do të merren nga nje kavë me e afërt.

KAPITULLI IV

- **Grafiku i punimeve**

Partneret kryesore për zbatimin e projektit janë komuniteti i fshatrave Shushicë, Fushë-Buall, Polis i Vogël dhe Polis-Valë, struktura e administrim menaxhimit të pyjeve pranë bashkisë Elbasan fuqia punëtore e nevojëshme për realizimin e punimeve, etj. Drejtuesi teknik i punimeve do të bëjë trajnimin e punëtorëve për mënyrën e kryerjes së proceseve të punës sipas planifikimit. Ritmiksht gjatë kryerjes së punimeve nga ana e stafit drejtues e drejtuesi teknik i punimeve, do të organizohen kontrolle për cilësinë e kryerjes së punimeve, në rast konstatimi të metash, lihen detyra për përmirësim.

Punimet për ndërtimin e Lerës, fillojnë mbas lidhjes së kontratës dhe trajnimit të punëtorëve. Për punimet e gërmimit, mund të punohet gjatë gjithë periudhës së vitit, për sitjen e dheut, krijimin e shtresës prej 20 cm me dhe dhe shtresës prej 20 cm kalldrëm duhet të punohet në ditë pa reshje. Gjatë monitorimit nga ana e drejtuesit teknik të punimeve e stafit drejtues të strukturës së pyjeve pranë bashkisë Elbasan do të ndiqen me përparësi treguesit:

Zbatimi i përmasave të gropës, cilësia e punimeve për rrafshimin e skarpatave dhe pastrimit nga gurët, qepja (bashkimi) i shtresave të plasmasit, trashësia dhe ngjeshja e shtresës së dheut dhe këlldremit mbi plasmas.

Në mënyrë me të përmbledhur po paraqesim më poshtë grafikun për realizimin e punimeve për ndërtimin e kësaj lere.

Nr.	Aktiviteti	Muaji							Grupi i implementimit
		(kutintë e selektuara tregojnë aktivitetet e planifikuara, nga muaji i parë i zbatimit të projektit)							
		1	2	3	4	5	6	7	
A1	Sigurimi i fuqise punetore te nevojeshme per realizimin e punimeve								Subjekti kontraktor
A2	Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve.								Stafi drejtues i subjekti fitues Ing.
A3	Piketimi sipas specifikimeve të projektit								Punëtorët e trajnuar, stafi drejtues, drejtuesi teknik i punimeve.
A4	Punimet e gërmimit për hapjen e gropës, themeleve të trotuarit, sipas përmasave të përcaktuara në projekt.								Punëtorët e trajnuar, stafi drejtues, drejtuesi teknik i punimeve
A5	Sigurimi dhe transporti i bazës materiale të nevojshme.								Stafi drejtues, tekniku i punimeve
A6	Shtrimi shtresave (2 shtresa plasmas, 20 cm dhe i situ, 20 cm kalldrem)								Punëtorët e trajnuar, stafi drejtues, drejtuesi teknik i punimeve
A7	Ndërtimi i Lerës së ujit								Punëtorët e trajnuar, stafi drejtues, drejtuesi teknik i punimeve
A8	Kontrolli i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës								Stafi drejtues i subjektit, drejtuesi teknik i punimeve, grupi i monitorimit Drejtoria së Pyjeve Bashkia Elbasan

- Shpenzimet për realizimin e projektit**

Për relizimin e punimeve të planifikuara në këtë projekt, çmimet për njësi, janë bazuar në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit (*manuali i ndërtimit në portalin e-Albania*) dhe të analizave teknike të tyre. Bazuar në këto çmime, jane hartuar preventivat përkatës të cilët kanë vlerë totale **1,500,000** lekë.

- Të dhënat sipas modelit teknik të punimeve janë:**

Vlerësimi i buxhetit	± 1,500,000 lekë
-----------------------------	------------------

- Efektiviteti i veprës së ndërtuar (lerës):**

Arritja e qëllimit për ndërtimin e kësaj lere, do të bëjë të mundur sigurimin e ujit të pishëm për blegtorinë që frekuenton për kullotë këto teritore e në mënyrë të drejtpërdrejtë do të çojë në rritjen e numrit të blegtorisë, zgjatjen e periudhës së qënderimit në kullotë. Me sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë në periudhen e thatë të vitit, do të rrisi prodhimin e mishit, qumshtit (nënprodukteve) në masën 20 – 30 % në një sezon kullotje. Këto shifra të konvertuara në vlera monetare përbëjnë të ardhura të konsiderueshme për blegtorët e fshatit Shushicë, Fushë-Buall, Polis i Vogël, Polis-Valë, qe perdorin keto kullota pe kullotjen e blegtorise se tyre. Gjithashtu uji që do të grumbullohet në këtë lerë do të përdoret në rast të shfaqjes së ndonjë zjarri të

mundëshëm. Të ardhurat direkte që rezultojnë pas kryerjes së punimeve konsistojnë në shtesën e vlerës tarifore të kullotjes për sezon. Gjithashtu fermerët e fshatit Shushicë do përfitojnë në mënyrë indirekte pasi do rritet numri i krerëve të bagëtive që mbarështrojnë si dhe rendimenti/krerë, duke shtuar prodhimet blegtorale për konsum dhe për treg, çfarë do ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe zhvillimin e agroturizmit.

Fuqia punëtore e nevojëshme për realizimin e punimeve ka mundësi të sigurohet nga fshatrat në afërsi të objektit, pasi në këto fshatra dhe niveli i papunësisë është i lartë. Punëtorët do përfitojnë ekonomikisht si rezultat i pagesës për punimet e kryera. Nëpërmjet investimit synohet dhe të sensibilizohet komuniteti për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor.

- **Kuotimi për bazën materiale:**

Siç duket dhe nga struktura e elementëve të domosdoshëm për ndërtimin e kësaj lere, vetëm sigurimi volumnit të plasmasit ishte objekt kuotimi të ofertës.

Sigurimi i volumnit të plasmasit të domosdoshëm për shtrim do të sigurohet në parametra teknik nga subjekti fitues që do të rezultojë nga procesi i prokurimit publik. Për ndërtimin e lerës nevojiten 767 m² plasma, me trashësi 0.6 mm.

Në përcaktimin e pagesës për ditë pune, është marrë në konsideratë paga e përcaktuar sipas kategorive të proceseve të punës në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (*manuali i ndërtimit në portalin e-Albania*).

- **Analiza e riskut:**

Në arritjen e objektivit për ndërtimin e lerës në ngastrën nr.100/b, e cila është përzgjedhur për t'u ndërtuar në një vend të përshtatshëm nga ana konstruktive, por dhe të përshtatshëm për përdorim nga blegtorja e këtyre fshatrave. Ndërtimi i kësaj vepre nuk paraqet ndonjë rrisht, pasi do të merren të gjitha masat tekniko-organizative nga përfaqësuesit e subjektit, për kryerjen e të gjitha fazave të punimeve në cilësinë e projektuar. Por gjithësesi vëmendje dhe kujdes duhet të tregohet në fazën e shtrimit të shtresave të plasmasit, shtrimin e shtresës së dheut mbi plasamën, të cilat janë procese delikate që ndikojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e funksionit të kësaj vepre.

Për arritjen dhe përfundimin në cilësinë e duhur të ndërtimit të kësaj lere do të merren të gjitha masat paraprake të bazës materiale, por duke siguruar dhe punëtore më shumë eksperiencë në të tilla aktivitete. Gjatë gjithë fazave të punimeve të fshehta do të asistohet dhe do të jenë prezent sëbashku me përfaqësuesit e subjektit dhe përfaqësuesit Shërbimit Pyjor që do të monitorojnë këtë aktivitet.

Për arritjen e objektivave të parashikuar mund të paraqiten vështirësi në sigurimin e fuqisë punëtore të nevojëshme, kryesisht gjatë periudhës së punimeve në kulturat bujqësore, pasi aktiviteti kryesor i banorëve të fshatrave për rreth objektit, është kryesisht bujqësia e blegtorja.

KAPITULLI V

(Aneks)

Harta e ngastrës e gjeoreferuar në KRRGJSH (vendit ku do ndërtohet lera) dhe ndarjet pyjore ku do ndërtohet lera.


Profili i lerës

- Pamje nga lart.

- Profili i objektit me elementët përkatës të dimensionuar në shkallën përkatëse.
Foto dixhitale te vendit ku do të ndërtohet objekti
Planimetria e parcelës, nënparcelës.


PROFILI I LERËS

- Pamje nga lart :



- Profili i objektit me elementët përkatës të dimensionuar me shkallën përkatëse.

PRERJA B- B



- D.** Dimetri i madh i lerës pas ndërtimit të strukturave
D1. Diametri i madh i lerës (Gërmim)
D2. Dimetri i trotuarit
D3. Diametri i oborrit të lerës
d. diametri i vogël i lerës pas ndërtimit të strukturave
d1. diametri i vogël i lerës (Gërmim)
h. Thellësia e lerës pas ndërtimit të strukturave
h1. Thellësia e lerës (Gërmim)

- Vu.** Kapaciteti max.ujëmbajtës i lerës
Vg. Volumi i gërmimeve për sipërf.të rrafshët
Sk. Pjerrësia e skarpatës ((jo më vogël se 2:1 ($\leq 50\%$)))
H. Thellësia e konit të lerës
Sb. Sipërfaqja e bazës së vogël
Sa. Sipërfaqja anësore e lerës
St. Sipërfaqja e trotuarit
So. Sipërfaqja e oborrit
M.Rr. Muri rrethues i lerës


<i>D</i>	<i>D1</i>	<i>D2</i>	<i>D3</i>	<i>d</i>	<i>d1</i>	<i>h</i>	<i>h1</i>	<i>Vu</i>	<i>Vg</i>	<i>Sk</i> (%)	<i>H</i>	<i>Sb</i>	<i>Sa</i>	<i>So</i>	<i>Mr</i>
17	17.8	18.8	20.8	6	6.8	2	2.4	223	303	43	3	36	232	27	0

PLAN-VENDOSJA E NGASTRËS PYJORE QË PLANIFIKOHET TË NDËRTOHET LERA
SH: 1: 5 000 (KRRGJSH)

514400

514800

515200



ING. ASTRIT MUÇI